



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI"
Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me datë	13.05.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-172

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref. 01-_____

Prizren, me: ___/___/_____

Bazuar në dispozitat e nenit 16 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 , si dhe vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetit „Ukshin Hoti“ në Prizren nr. 01-111 , shpall:

KONKURS
PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENTËT E UUHP-SË

Ftohen studentët e diplomuar në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren që të aplikojnë për punë praktike në administratën e Universitetit.

Puna praktike ka si objektive që t'ju ofrojë studentëve mundësi që dijen teorike të nxënë gjatë studimeve, ta aplikojnë në praktikë, duke krijuar përvojë të punës në administratë, si staf mbështetës në njësitë administrative të UUHP-së.

Numri i pozitave: 10 praktikantë.

Kohëzgjatja e punës praktike : 3 muaj

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

- Kandidatët për punë praktike duhet të jenë studentë së paku në vitin e dytë apo të kenë të përfunduar studimet në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren"(baçelor dhe master).
- Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike, komisioni do të marrë parasysh notën mesatare të studentëve.
- Praktikantí/ja preferohet të ketë: Shkathtësi të komunikimit; aftësi të mira analitike, Shkathtësi dhe njohuri në aplikimin e programeve kompjuterike nga pako Microsoft Office dhe shkathtësi në punë teknike; Aftësi të punës në grupe.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe mënyra e aplikimit

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

1. Kërkesën për shprehje interesi,
2. CV-në,
3. Certifikatën e notave,
4. Kopjen e diplomës ose certifikatës së diplomës
5. Kopjen e letërnjoftimit.

Konkursi mbetet i hapur 10 ditë.

- Data për aplikim është nga 13.05.2019 deri më 27.05.2019 në ora 16:00.
- Shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni ad hoc do të bëhet me datën 29.05.2019.
- Studentët e përzgjedhur për punë praktike, do të nënshkruajnë kontratën e angazhimit me Universitetin.
- Dokumentet duhen të dorëzohen në formatin elektronik pdf në e-mail adresën:apliko.upz@uni-prizren.com.
- Studentët do të jenë të angazhuar me orar të plotë sipas rregullores 05/2010 (08:00-16:00)
- Praktika për studentët e përzgjedhur do të zgjasë tre muaj (3 muaj), në periudhën maj-korrik 2019.

Kandidatët që nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që funksionon në kuadër të administratës së Universitetit.

Inkurajohen që të aplikojnë të gjithë studentët e UUHP-së pa kurrfarë dallimi, respektivisht të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Praktikantët në përfundim të punës praktike do të pajisen nga Universiteti "Ukshin Hoti" me: Referencë dhe Certifikatë.

Burim Berisha
Sekretari i Përgjithshëm